Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit

njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin përfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e çmimeve të artikujve

Nr	Përshkrimi i produkteve	Njësia	Sasia
1.	INFRASTRUKTURA HIPERKONVERGJENTE	set	1
2.	PAJISJA E KRIJIMIT TË KOPJES REZERVË NGA DISKU NË DISK HQ	njësi	1
3.	SOFTWARE PËR BACKUP	set	1
4.	PAJISJE SIGURIE FIREWALL HQ	njësi	2
5.	PAJISJE SIGURIE FIREWALL BRANCH	njësi	15
6.	TOP OF THE RACK SWITCH	njësi	2
7.	PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT TË INSTALIMIT DHE IMPLEMENTIMIT	set	1
8.	PËRSHKRIMI I FAZAVE TË PROJEKTIT/MIRËMBAJTJA	vit	1

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

INFRASTRUKTURA HIPERKONVERGJENTE.

a. Kërkesat e Përgjithshme:

- Kërkohet ndërtimi i një infrastrukture hiperkonvergjente e cila duhet të konsistojë në blerjen e licencave të software-it, hardware-it, suportit, dhe implementimit të saj;
- Infrastruktura hiperkonvergjente duhet të bazohet në servera me arkitekturë x86 dhe të ofrojë të gjitha burimet e CPU-ve, RAM-it, drive SSD, si dhe disponueshmëri të lartë;
- Infrastruktura hiperkonvergjente duhet të ketë: min 96 core te CPU-ve, min 1,500 Gb dhe min 115 TB SSD;

b. Veçoritë e software-it të virtualizimit:

- Të jetë e ndryshueshme, për të shtuar më shumë servera (server x86) si dhe disqe në serverat e zgjedhur;
- Të ketë mekanizëm të disponueshmërisë së lartë, brenda grupit të vetëm, duke e mbrojtur nga ndonjë dështim si pasojë e një elementi të vetëm të grupit (duke qene server ose hard disk i diskut SSD);
- Të ketë mekanizëm për balancimin e ngarkesës, duke siguruar një makinë të re virtuale në serverin më pak të ngarkuar;
- Të jetë fleksibel për të mbështetur një grup heterogjen, që do të thotë të ketë aftësinë të perziejë servera me numër të ndryshëm disqesh dhe kombinime të ndryshme të HDD-ve dhe SSD-ve, në një grup të vetëm;
- Të jetë fleksibel për të mbështetur si serverat vetëm me SSD dhe serverat hibride (serverat me përzierje HDD dhe SSD) në një grup të vetëm;
- Të ketë mundësi për të arritur disponueshmëri të vazhdueshme të aplikacioneve dhe zero humbje të të dhënave, duke përfshirë të dhënat VM, metadatat VM dhe politikat e mbrojtjes të aplikuara për VM-te ruajtura në grup;
- Numri i serverave në një grup të vetëm duhet të jetë së paku 32 dhe të bazohet në arkitekturë x86;
- Të mbështesë servera të ndryshëm x86
 - të paktën 2 vendor të ndryshme të serverave x86
 - duke i dhënë palës porositëse lirinë e zgjedhjes dhe mbrojtjen e investimeve;

- Të lejojë ndryshueshmëri të pakufizuar lineare, balancim të ngarkesës, vetë-rregullim, ruajtje të centralizuar;
 - Ndërlidhja ndërmjet serverave (për sinkronizimin e grupeve, balancimin dhe rindërtimin) duhet të realizohet nga rrjeti standard 25 GbE dhe switch-et core 25 GbE;
 - Të mbështesë 25GbE switch nga çdo vendor dhe nuk duhet të mbështesë konkretisht ndonjë model të veçantë, duke i dhënë autoritetit lirinë e mbrojtjes së investimit;
 - Të mbështesë hipervizorin ESXi, hipervizorin Microsoft Hyper-V dhe hipervizorin AHV;
 - mbështetja për hipervizorin KVM nuk kërkohet, por është një plus;
 - Të ketë kodimin e dedublikimit, kompresimit dhe fshirjes (EC-X), si në modalitetin inline ashtu edhe në modalitetin pas procesit (post-process);
 - Të ketë disponueshmëri të lartë, sipas RF 2 – një kopje e plotë e të dhënave duhet të jetë gjithmonë e pranishme;
 - Dëmtimi i ndonjë serveri të vetëm ose hard disk ose disku SSD në grup nuk mund të shkaktojë humbje të të dhënave të ruajtura;
 - Të ketë mekanizëm vete-shërues, d.m.th., në rast të dëmtimit të diskut ose dështimit të serverit, duhet të fillojë menjëherë procedurën e rikuperimit të një kopjeje të humbur të të dhënave;
 - Të mbështesë sistemin e skedarëve të shpërndarë, duke shpërndarë të dhënat në të gjithë serverat (serverët), por duhet të prezantohet si një magazinë e vetme e të dhënave për Makinat Virtuale;
 - Të mbështesë fotografitë e qëndrueshme të aplikimit;
 - Të lejojë integrimin me serverat ekzistues duke paraqitur burimet e ruajtjes së të dhënave mbi protokollin NFS;
- c. Veçoritë e software të menaxhimit:
- Të ketë sistemin e menaxhimit për Infrastrukturën hiperkonvergjente;
 - Sistemi i menaxhimit që kërkon servera të dedikuar shtesë nuk pranohet;
 - Të ketë të integruar ndërfaqen grafike të përdoruesit (GUI);
 - Të ketë API të integruar që funksionon në standardin REST API. Të gjitha funksionet e menaxhimit të disponueshme nëpërmjet ndërfaqes grafike të përdoruesit (GUI) duhet të jenë të disponueshme edhe nëpërmjet REST API;
 - Të lejojë funksionimin, automatizimin, monitorimin proaktiv, raportimin, njohuritë dhe analitikën;

- Të lejojë menaxhimin e të gjitha vendndodhjeve nga një pikë menaxhimi e vetme.
- Të ofrojnë funksione për të përmirësuar si software-in edhe hipervizorin, pa shkaktuar ndonjë ndërprerje në punën normale të të gjithë sistemit;
- Të zbulojë automatikisht burime të reja të hardware-it dhe të propozojë shtimin e tyre. Shtimi i burimeve Të reja hardware-it në sistem nuk mund të shkaktojë ndonjë ndërprerje në punën normale të të gjithë sistemit;
- Të ketë aftësinë për t'u lidhur me qëndren e shërbimit online për verifikimin e versioneve të reja të software-it;

d. Liçensimi:

- Liçencë për të gjitha core të propozuar nga vet prodhuesi i software;
- Liçencën për sistemin e menaxhimit nga vet prodhuesi i software;

e. Garancia:

- Garancia 1 vite nga prodhuesi 24x7 për hardware dhe software nga vet prodhuesi.

PAJISJA E KRIJIMIT TË KOPJES REZERVË NGA DISKU NË DISK HQ

a. Kërkesat e Përgjithshme:

- Zgjidhja e propozuar duhet të ketë pajisje për krijimin e kopjes rezervë nëpërmjet di skut të bazuar në arkitekturë me një dedublikim për ruajtjen e të dhënave.
- Zgjidhja duhet të dergojë në pajisje nepermejt rrjetit duke përdorur protokollet CIFS , NFS, NDMP dhe DD Boost.
- Zgjidhja duhet të suportoje mundësinë e përdorimit të kapacitetit të plotë llogjik si dhe mundësi zgjerimi në të ardhmen.
- Zgjidhja duhet të jetë e montueshme në rack me dy procesore prej 16 core secili.
- Zgjidhja duhet të ofrojë mundësi rritje të kësaj shpejtesie deri në 66TB/Hr duke përdorur plugins për deduplikim.
- Zgjidhja duhet të ofrojë mundësi për numrin maksimal të Librarive Virtuale dhe Tape që e suporton Sistemi i Backup-it.

-
- Zgjidhja duhet të përfshijë licencë për kapacitet të përdorshëm (usable) jo më pak se 40 TB.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë licencë për të suportuar kapacitet të përdorshëm (usable) në cloud tier jo më pak se 80TB.
 - Zgjidhja duhet të suportojë një kapacitet logjik jo më pak se 15PB.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë; 4 porta 25 b sfp28 dhe dy module sfp28 short range për lidhje me core switch.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë; 4 porta FC 32 Gb me module të përfshira për lidhje direkte me pajisjen e krijimit të kopjes rezerve në DR.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë 1 x 1 Gb Porte Menaxhimi.
 - Zgjidhja dhe kapaciteti i ofruar nga HDD duhet të jetë i mbrojtur me RAID6.
 - Zgjidhja duhet të ofrohet me disqe 7.2K rpm, 6G, SAS (Hot Plug).
 - Zgjidhja duhet të përfshijë të pakten cache me kapacitet 3.8TB SSD.
 - Zgjidhja duhet të ketë support për inline data deduplication.
 - Dedublikimi “Deduplication” duhet të kryhet me një madhësi të ndryshueshme blloku (variable block size).
 - Përveç dedublikimit të dhënave të ruajtura në pajisje duhet gjithashtu të kompresohen.
 - Opsionet e algoritmeve të kompresimit që mund të përzgjidhen duhet të jenë lz, gz dhe gz “fast” me kompresim të shpejtë.
 - Pajisja duhet të ofrojë mundësi enkriptimi (data-at-rest encryption)
 - Zgjidhja duhet të suportojë Global Deduplication (përgjate gjithë hapësirës, midis folderave të ndryshëm, VTL etj në mënyrë që të eliminohet të dhënave të dubluara midis kopjeve.
 - Zgjidhja duhet të suportojë verifikimin dhe integritetin të të dhënave të shkruajtura dhe ruajtura në të.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë replikim në të dy drejtimet burim/destinacion si point-to-point dhe multi-to-one.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë enkriptim në gjendje normale dhe gjatë replikimit.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë kompresim të të dhënave.
 - Zgjidhja duhet të përfshijë integrim me infrastrukturën virtuale për replikim të të dhënave të plotë të të dhënave dhe jo vetëm në nivel makine virtuale.
 - Zgjidhja duhet të suportojë integrim nativ me aplikacionet enterprise (Oracle, Microsoft SQL, SAP, IBM DB2, SAP HANA) duke përdorur plug-in software

ne aplikacionet e lartpermendura per te aktivizuar deduplikimin para se te dhenat te transmetohen ne destinacionin e ruajtjes. Ne kete rast mund te perdoret dhe Backup-i native i vet aplikacionit enterprise.

- Zgjidhja duhet te suportoje arkivimin e te dhenave me mundesine per ti ruajtur dhe mbrojtur retention lock.
 - Zgjidhja duhet te perfshije mundesine e vazhdueshmerise se sherbimeve ne rast pris hje te komponenteve si; Burim Ushqimi, Fan, Lidhjet Ethernet, Disqe.
 - Zgjidhja duhet te perfshije rikthim te te dhenave ne nivel File-i.
 - Zgjidhja duhet te perfshije nje nderfaqe menaxhimi intuitive si GUI dhe CLI.
 - Zgjidhja duhet te perfshije mundesine paraqitjes se nivelit te kompresimit, shpejtesis e se kalimit te te dhenave, raportime per trafikun ne hyrje dhe dalje.
 - Zgjidhja duhet te perfshije gjenerimin e nje raporti automatik dhe nderlidhje me qen dren e sherbimeve te prodhuesit.
 - Algoritmi i enkriptimit te sistemit duhet te jete AES-128bit.
- b. Garancia:
- Zgjidhja duhet te kete garanci min. 3 Vit 24x7x4 te ofruar nga vete prodhuesi.

SOFTWARE PËR BACKUP.

a. Kërkesat e Përgjithshme:

- Software duhet të sigurojë mbrojtje dhe replikim të vazhdueshem të të dhënave,
- Software duhet të sigurojë kopje rezervë për çdo ngarkesë pune,
- Software duhet të ketë mundësinë për të kryer rikthim të të dhënave.
- Software duhet të ofrojë një konsolë të vetme menaxhimi.
- Software duhet të mbështesë të dhëna të llojeve të ndryshme: të dhëna të strukturuar a (databazë të dhënash) dhe jo të strukturuar (PDF, Email, Video).
- Software duhet të kopjojë automatikisht çdo kopje rezervë në vendndodhjen e ruajtjes DR të zgjedhur, duke e verifikuar dhe riparuar për të siguruar që kopjet janë të di sponueshme dhe të besueshme
- Software duhet të ruaje dhe arkivojë të dhënat në mënyrë efikase.
- Software duhet të krijojë raporte bazuar ne performancën e zgjidhjes dhe punën e kryer.

- Software duhet të rivendosë ose të migrojë në mjediset e institucionit, bazuar në Windows, VM-të e bazuara në Linux, servera fizikë dhe pikat fundore direkt në AWS, Microsoft Azure dhe Microsoft Azure Stack.
 - Software të ofrojë orkestrim për Hyper-V/VMware dhe Azure Local (Azure Stack HCI) për rikuperim ndër-platformash nga fillimi në fund dhe migrim të planifikuar me konfigurim me zero humbje të të dhënave.
 - Software të kryejë dokumentim të konfigurimeve për të qenë e gatshme para procesit të rikuperimit në rast fatkeqësie duke kontrolluar pikat e disponueshme të rikthimit, infrastrukturën kritike dhe kredencialet e nevojshme.
 - Software duhet të rivendosë skedarët, aplikacionet nga Snapshot.
 - Software duhet të replikojë VM-të periodikisht në mjediset e institucionit për HA ose jashtë sajtit për DR.
 - Software duhet t'i mbajë kopjet rezervë të sigurta nga, malware dhe nga hakerët, ne kopje rezervë të pandryshueshme që parandalojnë enkriptimin dhe fshirjen nga ransomware dhe nderhyrjet keqdashëse.
 - Software duhet të ofrojë monitorim 24/7, raportim, analitikë, orkestrim duke eliminuar dështimet dhe humbjen e të dhënave.
 - Software duhet të ketë aftësinë për të arkivuar versione specifike të skedarëve për një periudhë më të gjatë kohore me backup rezervë për ndarjen e skedarëve
 - Software duhet të ofrojë vazhdimësi të shërbimeve.
- b. Licensimi dhe garancia:
- Software duhet të licençohet për 30 makina virtuale me mbështetje 1 vjeçare nga vet prodhuesi i software.

PAJISJE SIGURIE FIREWALL HQ.

- a. Karakteristikat minimale të pajisjes dhe performances:
- E instalueshme në kabinet - 1U, kit dhe kabujt të jenë të perfshirë
 - Min 8 porta 10Mbps/100Mbps/1Gbps/2.5Gbps/5Gbps RJ-45 nga të cilat 4 porta të ketë suport PoE me buxhet maksimumi 90W per wifi/ AP
 - Min 8 porta 1G/10G SFP/SFP+ bazuar në modulet e instaluar për uplink.
 - Min 4 porta 10Mbps/100Mbps/1Gbps RJ-45
 - Min 1 porte 10Mbps/100Mbps/1000Mbps për menaxhim
 - Min 1 10G SFP+ që shërbejnë për disponueshmeri të lartë.

- 1 porte RJ-45 konsole , 1 porte Micro USB konsole me perdorim standard Type-A USB-to-micro kabell USB.
- 1 porte USB që pranon flash drive USB per te kryer upgrade dhe kopjuar konfigurime
- Min 240 GB SSD Storage
- Firewall throughput (HTTP Layer 7 duke perdorur identifikimin e aplikacioni dhe aktivizimin e logeve): 9.5 Gbps
- Threat prevention throughput (HTTP Layer 7 duke perdorur identifikimin e aplikacionit, IPS, antivirus, antispymware, sandboxing, DNS Security, bllokim dhe aktivizim të skedareve dhe logeve): 6 Gbps
- IPSec VPN Throughput me madhesi pakete http 64 KB: 5.5 Gbps
- Sesione të njekoheshme: 1.4M
- Sesione të reja per sekonde: 140K
- Power supply redundante 450 watt AC (300W max power consumption)
- Periudhe besueshmerie te pajisjes: mbi 20 vjet
- Çip sigurie te integruar ne pajisje që ofron mbrojtje me celsa kriptografike të nivelit të lartë, certifikata dixhitale, kredenciale sekrete qe ruhen për të mbrojtur sistemin nga manipulimi dhe komprometimi.

b. Specifikime teknike të software:

- Zgjidhja duhet të ofroje vizibilitet dhe aftesi per identifikimin apo kufizimin e aplikacioneve pavarisht teknikave, portave, protokollit, enkriptimit (TLS/SSL) apo perdorimit të portave jo standarte ne aspektin e sigurise.
- Zgjidhja duhet të suportoje ndarjen e planit të menaxhimit të firewall (aksesimi i GUI dhe konfigurimin e tij) me planin e të dhenave të firewall (trajtimi i trafikurt që kalon permes tij).
- Zgjidhja duhet të suportoje nje baze të dhenash me mbi alikacione, të cilat të filtrohe n ne menyre dinamike sipas: kategorive, nenkategorit, menyra e sjelljes apo faktori i riskut.
- Zgjidhja duhet të kete mundesi të kategorizojë URL ne firewall nepermjet webgui.
- Zgjidhja duhet të kete aftesine per të importuar burime kercenimi të paleve të treta n e firewall.
- Zgjidhja duhet të perdore nje platforme webgui të vetme per menaxhimit e kercenimeve, firewalleve, politikave të IPS si dhe regjistrimin.

-
- Zgjidhja duhet të identifikojë skedare apo pattern në brendësi të aplikacioneve me qëllim bllokimin e skedareve me qëllim të keq apo nxjerrjen e të dhënave.
 - Zgjidhja duhet të suportoje zbatimin e IPS, Anti-Malware, filtrimin e permbajtjes, filtrimin URL sipas një rregulli të vetëm sigurie.
 - Zgjidhja të suportoje nënshkrimet e IPS për zbulimin e Post Quantum Cyphers (PQC)
 - këto algoritma kriptografike që përdoren nga aktore me qëllim nxjerrjen e të dhënave apo futjen e malware pa u identifikuar.
 - Zgjidhja duhet të suportoje QoS bazuar në burim/destinacionin IP, porte, protokoll dhe aplikacione.
 - Administratori duhet të ketë mundësinë të menaxhojë firewallin lokalisht nepermjet webgui të integruara dhe një platforme menaxhimi opsionale të jashtme.
 - Zgjidhja duhet të ketë mundësi për krijimin e politikave të sigurisë të cilat parandalojnë vjedhjen e kredencialeve, mbrojnë zbulimin e kredencialeve të institucionit në faqet e internetit apo parandalojnë ripërdorimin e kredencialeve të vjedhura duke aktivizuar autentikim të dyfishtë (MFA) në shtresën e rrjetit për çdo aplikacion pa i ndryshuar ato.
 - Zgjidhja të suportoje mbrojtjen e sigurisë DNS si: DNS callback për zbulimin e domain (malware & C2 Domain-e, Botnet domain-e, Fast-flux domain-e, random DGA, dictionary DGA), DNS high risk domain-e (grayware, domene të sapo regjistruara, domain në qendrim, shmangje të proxy, dns dinamike, zbulime të parashikuara, domene të vjetra), rregjistrimi i sulmeve të DNS (Domain squatting, dangling DNS, compromised DNS Zone, Wildcard DNS, CNAME cloaking), sulmet e protokollit DNS (DNS Rebinding, NXNS Attacks), zbulimi i tunelit DNS, ultra-slow DNS tunneling dhe DNS infiltration, suport për DNS Sinkholing për identifikimin e hosteve të infektura të rrjetit.
 - Nënshkrimet dhe permbajtja e Antiviruesit dhe filtrimit URL duhet të ofrohen nga i njëjti prodhues i vet pajisjes firewall pa asnjë permbajtje nga palë të treta.
 - Zero-Day Malware duhet të suportoje protokollin e mëposhtme: HTTP, HTTPS, SMTP, SMTPS, IMAP, IMAPS, FTP, dhe SMB.
 - Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të deshifrojë protokollin e mëposhtme: SSL, SSH, të inspektojë dhe zbatojë rregulla për trafikun e koduar TLS/SSL në hyrje dhe në dalje përfshirë dhe trafikun që përdor TLS 1.3 dhe HTTP/2.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë vizibilitet të detajuar pa deshifrim në trafikun TLS, të tilla si sasia e trafikut të koduar, versionet TLS/SSL, shifrat e paketave edhe me shumë. Zgjidhja duhet të mundësojë kontroll mbi përdorimin e protokolleve legacy TLS, shifrave të pasigurta apo certifikatave të konfiguruar gabim.

-
- Zgjidhja duhet të dergojë një kopje të trafikut të deshifruar nga firewalli në tool-in për analizim të trafikut për inspektim, qellime historike apo parandalimin e humbjes së të dhënave (DLP).
 - Zgjidhja të ofrojë analizim të avancuar për malware (malware sandboxing) duke përfshirë dhe ekzekutim apo skanim për MacOS dhe Linux.
 - Zgjidhja e avancuar për malware duhet të jetë e miratuar sipas standartit FedRamp.
 - Zgjidhja duhet të integrohet lehtësisht me një game të gjere repositore për të shfrytëzuar informacionin e përdoruesit dhe të jetë në gjendje të marrë identitetet e përdoruesve nga: LDAP, Captive Portal, VPN, NACs (XML or API), Client Probing, Syslog, Terminal Services, XFF Headers, Server Monitoring.
 - Zgjidhja duhet të suportoje integrimin me burimet e directorive për rregullat e bazuar në përdorues dhe grupe nga Microsoft AD, Azure AD, Okta, Google, PingID.
 - Zgjidhja duhet të suportoje IdPs për autentikimin në cloud (SAML): Azure, PingID, Okta, Google, other SAML 2.0 IdPs.
 - Zgjidhja duhet të suportoje identitetin dhe autentikimin për ofruesit e shërbimit on-prem apo në cloud si edhe të zbatojë kontrollë bazuar në përdorues për ambiente on-prem dhe cloud.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë suport të plotë pa pagesë për open API për të aksesuar Dev Toolkit, Tools dhe skripte.
 - Zgjidhja duhet të jetë e pajtueshme me standardin e sigurisë CIPA për kerkim të sigurt në google dhe youtube.
 - Zgjidhja duhet të mundësojë krijimin e raporteve standarte, të personalizuar si edhe raporte direkte nga webgui.
 - Zgjidhja duhet të mundësojë rigrupim të përdoruesve në mënyrë dinamike dhe automatike bazuar në eventet e sigurisë, pa qenë nevoja për përgjigje manuale.
 - Zgjidhja duhet të ketë aftësi për të identifikuar algoritmat e gjenerimit të Domain në trafikun DNS për mbrojtje ndaj exfiltrimit të të dhënave.
 - Zgjidhja duhet të ketë aftësi të etiketojë objektet që të zbatojë politikën në mënyrë dinamike pa marrë parasysh ndryshimin në IP, zone apo drejtimin e trafikut në burim pa qenë nevoja e rikompozimit të politikave të sigurisë.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë algoritma Machine Learning për mbrojtje të avancuar drejtpërdrejt nga firewall pa lidhje të jashtme të nevojshme e për të siguruar nënskrime për parandalimin e sulmeve, identifikimin dhe ndalimin e tentativave të phishing të panjohura me parë.

- Zgjidhja duhet të ketë mundësi, pa ndikuar në performancën e trafikut të aktivizojë çdo funksionalitet të ri sigurie të ofruar si: kontroll i aplikacioneve, IPS, antivirus, antispysware, sandboxing, web filtering, DNS Security, file blocking, SSL dhe IPsec VPN.
- Zgjidhja duhet të suportoje në mënyrë automatike politikat e sigurisë të rekomanduara në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e gabimit njerzor.
- Zgjidhja duhet të ofrojë gjurmim gjatë procesit të konfigurimit të politikave si edhe të pranojë rekomandime të personalizuar për konfigurimet kritike për të adresuar praktikën me të mira gjatë implementimit.
- Zgjidhja duhet të ofrojë suport proaktiv për mbështetje të problemeve hardware, software përdorimin e burimeve, regjistrimin e logeve, zonat e mbrojtjes, kufijtë e kontenteve të konfigurimeve të vet firewall.
- Zgjidhja duhet të ofrojë funksione të avancuara, përfshirë Compliance Reports (si NIST CSF) dhe MITRE ATT&CK® Technique ID Mapping, Vulnerability, Risk Assessment, Prioritization, Zero-Day Detection/Protection.
- Zgjidhja duhet të identifikojë, klasifikojë dhe gjurmojë pajisjet IoT, OT, IT të menaxhuara ose jo.
- Zgjidhja duhet të ofrojë Zero Trust Policy Enforcement çdo përdorues, pajisje, aplikacion dhe transaksion duhet të verifikohet vazhdimisht.
- Zgjidhja duhet të njoftojë në mënyrë automatike përmes e-mail kur ka thyerje të sigurisë apo vet statusit të firewall.
- Zgjidhja duhet të analizojë trafikun dhe skedarët në kohë reale (inline) duke përdorur motorët e analizës në cloud para se trafiku të lejohet të kalojë te përdoruesi ose në rrjet.
- Zgjidhja duhet të ketë të integruar në mënyrë native teknologjinë SD-WAN në firewall duke ofruar përvojë më të mirë të përdoruesve duke minimizuar vonesat, ndërhyrje apo humbje të paketave.
- Zgjidhja duhet të zbatojë politikë të qëndrueshme pavarësisht nga vendndodhjet e përdoruesve dhe pajisjeve që përdorura (pajisjet celulare iOS dhe Android; macOS).

c. Menaxhimi.

Zgjidhja duhet të përfshirë një platformë menaxhimi të unifikuar on-prem të ofrojë funksionalitetet e mëposhtme për firewallin në HQ dhe branch-e si:

- hierarki në organizimin e grupeve dhe politikave,
- template për konfigurimin e pajisjeve firewall,
- update dhe upgrade të unifikuar për pajisjet firewall,

- sd-wan dhe disponueshmeri te zgjidhjes,
- zero touch provision te firewall ne distance,
- te ofroje vizibilitet dhe vendosje te centralizuar te pajisjeve firewall,
- profilizim te statusit te firewall dhe perdorimin e tyre.
- rol te vetem sigurie per: firewall, parandalimin e kërcënimeve, filtrimin e URL-së, ndërgjegjësimin e aplikacionit, identifikimin e përdoruesit, bllokimin e skedarëve, kontrollin e aksesit dhe filtrimin e të dhënave,
- pershikallzim per menaxhimin e pajisjeve shtese duke shtuar numrin e licencave per pajisje,
- administrim bazuar ne role per delegimin e akseseve dhe disponibilitetit e të dhënave,
- kjo platforme duhet te jete plotesisht e integrueshme dhe instalueshme ne platforme n HCI te ofruar.

d. Licencimi.

- Zgjidhja të ofroje licensim të pajtueshem me funksone te avancuara dhe AI per nje periudhe nje vjecare per web security, advanced url filtering, dns protection, sd-wan, IoT security.

e. Garancia.

- Garancia e pajisjes duhet të ofrohet për një periudhë nje vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit, e-mail, chat apo telefon.
- Garancia e ofruar duhet të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi

PAJISJE SIGURIE FIREWALL BRANCH.

a. Karakteristikat minimale të pajisjes dhe performances:

- Min 8 x 1GbE RJ45 te cilat te sherbejne si porta WAN/LAN/HA,
- 1 porte RJ-45 konsole , 1 porte Micro USB konsole me perdorim standard Type-A USB-to-micro kabell USB,
- Min 1 porte USB që pranon flash drive USB per te kryer upgrade dhe kopjuar konfigurime
- Min 128 GB Storage
- Firewall throughput (HTTP Layer 7 duke perdorur identifikimin e aplikacioni dhe aktivizimin e logeve): 1.8 Gbps

- Threat prevention throughput (HTTP Layer 7 duke përdorur identifikimin e aplikacionit, IPS, antivirus, antispysware, sandboxing, DNS Security, bllokim dhe aktivizim të skedareve dhe logeve): 1Gbps
- IPSec VPN Throughput me madhësi pakete http 64 KB: 800 Mbps
- Sesione të njëkohshme: 95K
- Sesione të reja për sekonde: 25K
- Power supply 100-240V AC
- Periudha besueshmërie të pajisjes: mbi 20 vjet
- Çip sigurie të integruar në pajisje që ofron mbrojtje me celsa kriptografike të nivelit të lartë, certifikata dixhitale, kredenciale sekrete që ruhen për të mbrojtur sistemin nga manipulimi dhe komprometimi.

b. Specifikime teknike të software:

- Zgjidhja duhet të ofrojë vizibilitet dhe aftësi për identifikimin apo kufizimin e aplikacioneve pavarësisht teknikave, portave, protokollit, enkriptimit (TLS/SSL) apo përdorimit të portave jo standarte në aspektin e sigurisë.
- Zgjidhja duhet të suportoje ndarjen e planit të menaxhimit të firewall (aksesimi i GUI dhe konfigurimin e tij) me planin e të dhënave të firewall (trajtimi i trafikut që kalon përmes tij).
- Zgjidhja duhet të suportoje një bazë të dhënash me mbi aplikacione, të cilat të filtrohen në mënyrë dinamike sipas: kategorive, nënkategorive, mënyrës së sjelljes apo faktori i riskut.
- Zgjidhja duhet të ketë mundësi të kategorizojë URL në firewall nëpërmjet webgui.
- Zgjidhja duhet të ketë aftësi për të importuar burime kërcënimi të paleve të treta në firewall.
- Zgjidhja duhet të përdorë një platformë webgui të vetme për menaxhimin e kërcënimeve, firewallëve, politikave të IPS si dhe regjistrimin.
- Zgjidhja duhet të identifikojë skedare apo pattern në brendësi të aplikacioneve me qëllim bllokimin e skedareve me qëllim të keq apo nxjerrjen e të dhënave.
- Zgjidhja duhet të suportoje zbatimin e IPS, Anti-Malware, filtrimin e përmbajtjes, filtrimin URL sipas një rregulli të vetme sigurie.
- Zgjidhja të suportoje nënshkrimet e IPS për zbulimin e Post Quantum Cyphers (PQC)
 - këto algoritma kriptografike që përdoren nga aktore me qëllim nxjerrjen e të dhënave apo futjen e malware pa u identifikuar.

-
- Zgjidhja duhet të suportoje QoS bazuar ne burim/destinacionin IP, porte, protokoll dhe aplikacione.
 - Administratori duhet të ketë mundësi të menaxhojë firewallin lokalisht nepermjet webgui të integruara dhe një platforme menaxhimi opsionale të jashtme.
 - Zgjidhja duhet të ketë mundësi për krijimin e politikave të sigurtisë të cilat parandalojnë vjedhjen e kredencialeve, mbrojnë zbulimin e kredencialeve të institucionit në faqet e internetit apo parandalojnë ripërdorimin e kredencialeve të vjedhura duke aktivizuar autentikim të dyfishtë (MFA) në shtresën e rrjetit për çdo aplikacion pa i ndryshuar ato.
 - Zgjidhja të suportoje mbrojtjen e sigurtisë DNS si: DNS callback për zbulimin e domain (malware & C2 Domain-e, Botnet domain-e, Fast-flux domain-e, random DGA, dictionary DGA), DNS high risk domain-e (grayware, domene të sapo regjistruara, domain në qendrim, shmangje të proxy, dns dinamike, zbulime të parashikuara, domene të vjetra), rregjistrimi i sulmeve të DNS (Domain squatting, dangling DNS, compromised DNS Zone, Wildcard DNS, CNAME cloaking), sulmet e protokollit DNS (DNS Rebinding, NXNS Attacks), zbulimi i tunelit DNS, ultra-slow DNS tunneling dhe DNS infiltration, suport për DNS Sinkholing për identifikimin e hosteve të infektura të rrjetit.
 - Nenshkrimet dhe përmbajtja e Antiviruesit dhe filtimit URL duhet të ofrohen nga i njëjti prodhues i vet pajisjes firewall pa asnjë përmbajtje nga pale të treta.
 - Zero-Day Malware duhet të suportoje protokollin e mëposhtme: HTTP, HTTPS, SMTP, SMTPS, IMAP, IMAPS, FTP, dhe SMB.
 - Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të deshifrojë protokollin e mëposhtme: SSL, SSH, të inspektojë dhe zbatojë rregulla për trafikun e koduar TLS/SSL në hyrje dhe në dalje përfaqësojë dhe trafikun që përdor TLS 1.3 dhe HTTP/2.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë vizibilitet të detajuar pa deshifrim në trafikun TLS, të tilla si sasia e trafikut të koduar, versionet TLS/SSL, shifrat e paketave edhe me shumë. Zgjidhja duhet të mundësojë kontroll mbi përdorimin e protokolleve legacy TLS, shifra të pasigurta apo certifikatave të konfiguruar gabim.
 - Zgjidhja duhet të dergojë një kopje të trafikut të deshifruar nga firewalli në tool-in për analizim të trafikut për inspektim, qellime historike apo parandalimin e humbjes së të dhënave (DLP).
 - Zgjidhja të ofrojë analizim të avancuar për malware (malware sandboxing) duke përfshirë dhe ekzekutim apo skanim për MacOS dhe Linux.
 - Zgjidhja e avancuar për malware duhet të jetë e miratuar sipas standartit FedRamp.

-
- Zgjidhja duhet të integrohet lehtësisht me një game të gjere repositore për të shfrytëzuar informacionin e përdoruesit dhe të jetë në gjendje të marrë identitetet e përdoruesve nga: LDAP, Captive Portal, VPN, NACs (XML or API), Client Probing, Syslog, Terminal Services, XFF Headers, Server Monitoring.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë integritet me burimet e directorive për rregullat e bazuar në përdorues dhe grupe nga Microsoft AD, Azure AD, Okta, Google, PingID.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë IdPs për autentikimin në cloud (SAML): Azure, PingID, Okta, Google, other SAML 2.0 IdPs.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë identitetin dhe autentikimin për ofruesit e shërbimit on-prem apo në cloud si edhe të zbatojë kontrolle bazuar në përdorues për ambiente on-prem dhe cloud.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë suport të plotë pa pagesë për open API për të aksesuar Dev Toolkit, Tools dhe skripte.
 - Zgjidhja duhet të jetë e pajtueshme me standartin e sigurisë CIPA për kërkim të sigurt në Google dhe YouTube.
 - Zgjidhja duhet të mundësojë krijimin e raporteve standarte, të personalizuar si edhe raporte direkte nga webui.
 - Zgjidhja duhet të mundësojë rigrupim të përdoruesve në mënyrë dinamike dhe automatike bazuar në eventet e sigurisë, pa qenë nevoja për përgjigje manuale.
 - Zgjidhja duhet të ketë aftësi për të identifikuar algoritmat e gjenerimit të Domain në trafikun DNS për mbrojtje ndaj exfiltrimit të të dhënave.
 - Zgjidhja duhet të ketë aftësi të etiketojë objektet që të zbatojë politikat në mënyrë dinamike pa marrë parasysh ndryshimin në IP, zone apo drejtimin e trafikut në burim pa qenë nevoja e rikompozimit të politikave të sigurisë.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë algoritma Machine Learning për mbrojtje të avancuar drejtpërdrejt nga firewall pa lidhje të jashtme të nevojshme e për të siguruar nënshkrime për parandalimin e sulmeve, identifikimin dhe ndalimin e tentativave të phishing të panjohura me parë.
 - Zgjidhja duhet të ketë mundësi, pa ndikuar në performancën e trafikut të aktivizojë çdo funksionalitet të ri sigurie të ofruar si: kontroll i aplikacioneve, IPS, antivirus, antispyware, sandboxing, web filtering, DNS Security, file blocking, SSL dhe IPsec VPN.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë në mënyrë automatike politikat e sigurisë të rekomanduara në mënyrë që të zvogëlohet mundësia e gabimit njerzor.
 - Zgjidhja duhet të ofrojë gjurmim gjatë procesit të konfigurimit të politikave si edhe të pranohet rekomandime të personalizuar për konfigurimet kritike për të adresuar praktikën me të mira gjatë implementimit.

- Zgjidhja duhet të ofroje suport proaktiv për mbështetje të problemeve hardware, software përdorimin e burimeve, regjistrimin e logeve, zonat e mbrojtjes, kufijtë e kontenteve të konfigurimeve të vet firewall.
- Zgjidhja duhet të ofroje funksione të avancuara, përfshirë Compliance Reports (si NIST CSF) dhe MITRE ATT&CK® Technique ID Mapping, Vulnerability, Risk Assessment, Prioritization, Zero-Day Detection/Protection.
- Zgjidhja duhet të identifikojë, klasifikojë dhe gjurmojë pajisjet IoT, OT, IT të menaxhuara ose jo.
- Zgjidhja duhet të ofroje Zero Trust Policy Enforcement çdo përdorues, pajisje, aplikacion dhe transaksion duhet të verifikohet vazhdimisht.
- Zgjidhja duhet të njoftojë në mënyrë automatike përmes e-mail kur ka thyerje të sigurisë apo vet statusit të firewall.
- Zgjidhja duhet të analizojë trafikun dhe skedarët në kohë reale (inline) duke përdorur motorët e analizës në cloud para se trafiku të lejohet të kalojë te përdoruesi ose në rrjet.
- Zgjidhja duhet të ketë të integruar në mënyrë native teknologjinë SD-WAN në firewall duke ofruar përvojë më të mirë të përdoruesve duke minimizuar vonesat, ndërhyerje apo humbje të paketave.
- Zgjidhja duhet të zbatojë politikë të qëndrueshme pavarësisht nga vendndodhjet e përdoruesve dhe pajisjeve që përdorura (pajisjet celulare iOS dhe Android; macOS).

c. Menaxhimi.

Zgjidhja duhet të përfshijë licencë për platformën e menaxhimit të unifikuar on-prem në HQ e cila të mbulojë funksionalitetet e mëposhtme si:

- hierarki në organizimin e grupeve dhe politikave,
- template për konfigurimin e pajisjeve firewall,
- update dhe upgrade të unifikuar për pajisjet firewall,
- SD-WAN dhe disponueshmëri të zgjidhjes,
- zero touch provision të firewall në distancë,
- të ofrojë vizibilitet dhe vendosje të centralizuara të pajisjeve firewall,
- profilizim të statusit të firewall dhe përdorimin e tyre.
- rol të vetëm sigurie për: firewall, parandalimin e kërcënimeve, filtrimin e URL-së, ndërgjegjësimin e aplikacionit, identifikimin e përdoruesit, bllokimin e skedarëve, kontrollin e aksesit dhe filtrimin e të dhënave,
- përshkallzim për menaxhimin e pajisjeve shtesë duke shtuar numrin e licencave për pajisje,

-
- administrim bazuar ne role per delegimin e akseseseve dhe disponibilitetit e te dhenave,
 - kjo platforme duhet te jete plotesisht e integrueshme dhe instalueshme ne platforme n HCI te ofruar.

d. Licencimi.

- Zgjidhja të ofroje licensim të pajtueshem me funksone te avancuara dhe AI per nje periudhe nje vjecare per web security, advanced url filtering, dns protection, sd-wan, IoT security.

e. Garancia.

- Garancia e pajisjes duhet të ofrohet për një periudhë nje vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit, e-mail, chat apo telefon.
- Garancia e ofruar duhet të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi

TOP OF THE RACK SWITCH.

a. Karakteristikat minimale të pajisjes dhe performances:

- E instalueshme ne kabinet - 1U, kit dhe kabujt te jene te perfshire
- 24 porta ethernet 10/25GbE (SFP+/SFP28) dhe 4 porta 100GbE QSFP
- Memory: min 8GB
- Storage SSD: min 32 GB
- Switching Capacity: 2 Tbps full-duplex,
- Forwarding Rate: 1.4 Bpps full-duplex,
- PSU hot-swappable redundante
- Ventilatorë hot-swappable redundante
- MAC Addresses: min 32K
- IPv4 Hosts: min 16K
- IPv6 Hosts: min 8K
- Multicast Routes: min 16K

b. Karakteristikat e software

- Funksionalitete të avancuara L2 dhe L3

-
- VLAN
 - Spanning Tree (RSTP / MSTP)
 - LAG / LACP
 - Storm Control
 - Static routing
 - OSPF
 - BGP
 - VRF
 - Segmentim dhe manaxhim fabric për mjedise VXLAN EVPN
 - Telemetri të avancuar
 - Automatizim me API-ra modern
 - Zero-touch provisioning
 - Data Center Bridging
 - Streaming telemetry
 - sFlow
 - NetFlow
 - ACL (Access Control Lists) të avancuara
 - Port security
 - DHCP snooping
 - Dynamic ARP Inspection
 - Control Plane Policing (CoPP)
- c. Menaxhimi dhe Monitorimi
- CLI
 - SNMP për monitorim
 - API-ra moderne (RESTCONF/NETCONF)
 - IPMI për sensorë të brendshëm (temperaturë, fan, PSU)
- d. Garancia.
- Garancia e pajisjes duhet të ofrohet për një periudhë një vjeçare nga vetë prodhuesi dhe të përfshijë qasje në qendrën e tyre të shërbimit, e-mail, chat apo telefon.
 - Garancia e ofruar duhet të përfshijë përmirësimin e software të sugjeruar nga prodhuesi

PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT TE INSTALIMIT DHE IMPLEMENTIMIT

Zgjidhje e integruar: Infrastruktura hiperkonvergjente, Infrastrukture Backup për HQ/DR dhe pajisjeve të ndërlidhjes/sigurisë së rrjetit.

7.1 Hyrje

Ky dokument përshkruan arkitekturën, komponentët, fushën e shërbimeve dhe përgjegjësitë e operatorit ekonomik kundrejt shërbimeve operacionale që duhet të marrë përgjegjësi:

- Infrastruktura hiperkonvergjente (HCI)
- Pajisje të kopjes rezerve (HQ)/(DR) dhe software i backup
- Firewall perimetral (Edge Firewall)
- Top Of the Rack Switch

Qëllimi është krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme, të sigurt dhe të centralizuar me kohë reagimi të përcaktuara.

7.2 Përshkrimi i Zgjidhjes

7.2.1 Infrastruktura hiperkonvergjente (HCI)

- Menaxhim i centralizuar për compute dhe storage
- Redundancë dhe arkitekturë vetë-riparuese
- Shkallëzim linear duke shtuar node
- Virtualizim i integruar (VMware / Nutanix / Hyper-V)
- High Availability (HA)

Dorëzimet:

- Deploy i cluster HCI
- Konfigurimi i platformës së virtualizimit
- Politikat e storage (RAID / Erasure Coding)
- Monitorim dhe njoftim

7.2.2 Pajisje e kopjes rezerve HQ/DR

- Backup VM pa agent
- Pajisje/Software backup në HQ dhe DR
- Replikim WAN i optimizuar
- Ngritja e politikave të software të backup
- Instant recovery
- Politika backup sipas kërkesave të biznesit

Dorëzimet:

- Instalimi dhe konfigurimi i backup
- Politikat: oraret, retencionet, enkriptimi
- Replikimi HQ→DR
- Testim i rikuperimit (RTO/RPO)

7.2.3 Firewall Perimetral/branch dhe ToP the Rack Switch

-
- Firewall me inspektim stateful te avancuar
 - IPS/IDS te avancuar
 - Filtrim web dhe kontroll aplikacionesh te avancuar
 - High availability
 - DNS Security
 - IoT security
 - Nderlidhja e pajisjeve ne switcha
 - Integrimi ne infrastukturen e AK

Dorëzimet:

- Deploy dhe konfigurimi i firewalleve
- Nderlidhje me DR
- Profile sigurie per funksionet e avancuara te kerkuara
- VLAN, NAT, routing dhe segmentim

PËRSHKRIMI I FAZAVE TE PROJEKTIT/MIRËMBAJTJA

Objektivat

Operatori ekonomik duhet te marre persiper te realizoje: instalim, konfigurim, dokumentim, testim, migrim te sherbimeve ne cluster.

Operatori ekonomik duhet te marre persiper te realizoje me celsa ne dore: instalim, konfigurim, mbeshtetje me suport nga prodhueset, troubleshooting, SLA per per mirmbajtjen e sherbimeve te kerkuara ne kete procedure.

Autoriteti Kontraktor do te mbeshtete dhe suportoje OE me: infrastrukturë fizike ku do te instalohen sherbimet e kerkuara, akses dhe siguri fizike.

8.2 Aktivitetet Kryesore

8.2.1. Planifikimi

- Mbledhja e kërkesave
- Analiza e kapacitetit ekzistues
- Projektimi i arkitekturës

8.2.2. Implementimi dhe mirembajtje

- Instalimi i HCI dhe konfigurimi i cluster-it
- Deploy i pajisjeve të backup dhe konfigurimi i politikave
- Konfigurimi i firewall-ve, VPN dhe profileve të sigurisë
- Diagnostikim dhe zgjidhje problemesh
- Përditësime software dhe firmware sipas rekomandimeve
- Konsultim teknik për optimizime sipas prioritetit

8.2.3. Testimi

- Testim i performancës dhe HA

-
- Testim i backup dhe rikuperimit
 - Testim i politikave të sigurisë

8.2.4. Migrimi (nëse aplikohet)

- Migrim i VM-ve ose të dhënave

8.2.5. Dorëzimi i Dokumentimit

- Diagramat e arkitekturës
- Politikat e backup dhe replikimit
- Konfigurimet e firewall dhe akseset

8.2.6. Trajnimi i stafit

- Trajnim on job

8.2.7 Përfundimi i Projektit

Projekti konsiderohet i përfunduar kur:

- Të gjitha komponentët janë funksionalë
- Të gjitha testet janë kryer me sukses
- Dokumentacioni është dorëzuar
- AK ka nënshkruar pranimin përfundimtar

8.3 SLA/Mirmbajtje – Koha e Reagimit

Operatori Ekonomik duhet të pergjigjet dhe mirembaje infrastrukturen e ofruar për një periudhë njëvjeçare sipas termave dhe kriterëve të përshkruara si më poshtë:

P1 Kritike Rënie sistemi / risk humbjeje –brenda 1 orë

P2 Lartë Degradim / dështime backup - brenda 1 ditë pune

P3 Mesatar Probleme jo kritike - 2–3 ditë

P4 Ulët Kërkesa / ndryshime -brenda 5 ditë

8.3.1 Kriteret e Pranimit

- Cluster HCI funksional
- Backup me sukses
- Replikim HQ→DR i verifikuar
- Firewall funksional me politika aktive
- Nderlidhjet me switchat e datacenter
- Dokumentimi i zgjidhjeve të dorëzuara

8.3.2 Mbështetja Teknike

Ky seksion përshkruan llojet e mbështetjes teknike që duhet të ofrohen nga Operatori Ekonomik:

- Mbështetje 24/7 për incidentet kritike (P1)

- Mbështetje gjatë orarit zyrtar (08:00–16:00) për P2–P4
- Akses në sistemin e tiketeve apo raportimet.
- Eskalim tek inxhinierët senior në rastet e incidenteve të përsëritura
- Raporte të performancës dhe incidenteve (ne dakortesi midis AK dhe OE)

TABELA E PERGJTHSHME

Nr	Përshkrimi i produkteve	Njësia	Sasia
1.	INFRASTRUKTURA HIPERKONVERGJENTE	set	1
2.	PAJISJA E KRIJIMIT TË KOPJES REZERVË NGA DISKU NË DISK HQ	njësi	1
3.	SOFTWARE PËR BACKUP	set	1
4.	PAJISJE SIGURIE FIREWALL HQ	njësi	2
5.	PAJISJE SIGURIE FIREWALL BRANCH	njësi	15
6.	TOP OF THE RACK SWITCH	njësi	2
7.	PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT TE INSTALIMIT DHE IMPLEMENTIMIT	set	1
8.	PËRSHKRIMI I FAZAVE TE PROJEKTIT/MIRËMBAJTJA	vit	1

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	INFRASTRUKTURA HIPERKONVERGJENTE	1 set	Ukt sha	120 dite
2	PAJISJA E KRIJIMIT TË KOPJES REZERVË NGA DISKU NË DISK HQ	1 njesi	Ukt sha	120 dite
3	SOFTWARE PËR BACKUP	1 set	Ukt sha	120 dite
4	PAJISJE SIGURIE FIREWALL HQ	2 njesi	Ukt sha	120 dite
5	PAJISJE SIGURIE FIREWALL BRANCH	15 njesi	Ukt sha	120 dite
6	TOP OF THE RACK SWITCH	2 njesi	Ukt sha	120 dite
7	PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT TE INSTALIMIT DHE IMPLEMENTIMIT	1 set	Ukt sha	120 dite
8	PËRSHKRIMI I FAZAVE TE PROJEKTIT/MIRËMBAJTJA		Ukt sha	120 dite

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfutues në regjistrin e pronarëve përfutues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4 përkatësisht në është 2.791.102,6 (dy milion e shtatëqind e nentëdhjetë e një mijë e njëqind e dy presje gjashtë) lekë.*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës në monedhën ndërkombetare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 29.778,11 (njetzet e nente mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tete presje njëmbëdhjetë) euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 14.07.2026 është 93.73 euro.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023,2024,2025) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara, ose,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të ofruara.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) Çertifikatën për sigurinë e informacionit **ISO 27001:2022 (ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- c) Çertifikatën për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit **ISO 20000-1:2018 ose (ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

2.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose nga një Distributor i Autorizuar, përmes të cilit konfirmohet se operatori ekonomik është i autorizuar për tregtimin e të gjitha produkteve hardware dhe software të përfshira në objektin e këtij prokurimi.

Në rast se paraqitet autorizim i lëshuar nga një Distributor i Autorizuar, duhet të evidentohet dhe verifikohet qartë marrëdhënia zyrtare ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit Rajonal të Autorizuar, në mënyrë që të garantohej vlefshmëria dhe autenticiteti i autorizimit të paraqitur.

2.6 Operatori pjesëmarrës për të vertetuar që ka kapacitete njerezore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas termave të referencës të projektit, duhet të vertetojë se ka jo më pak se 8 (tete) Inxhinierë/Specialistë të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike / Inxhinieri Informatike / Teknologji Informacioni / Informatike / Informatike Matematike / Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatike Ekonomike / Telekomunikacion / Inxhinieri Telekomunikacion që do të angazhohen në implementimin e projektit, ku të vertetohen nëpërmjet diplomës dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave), nga të cilët:

- a) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar si Menaxher Projekti, PMP ose ekuivalent;
- b) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT, ITIL ose ekuivalent;
- c) Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar në nivel profesional nga prodhuesi për infrastrukturën hiperkonvergjente HCI të ofertuar ose ekuivalent;

-
- d) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi per pajisje e krijimit të kopjes rezervë nga disku në disk te ofertuar ose ekuivalent;
 - e) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar ne nivel profesional nga prodhuesi ose ekuivalent per servera;
 - f) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi per software per backup te ofertuar ose ekuivalent;
 - g) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi per pajisje firewall te ofertuar ose ekuivalent;
 - h) Te pakten 2 (dy) specialiste te certifikuar nga prodhuesi ne nivel profesional per rrjetat CCNP ose ekuivalent;
 - i) Te pakten 1 (një) specialist te certifikuar CIR “Certified Incident Responder” ose ekuivalente;
 - j) Te pakten 2 (dy) specialist te certifikuar “Cyber Threat Hunting Professional” ose ekuivalente;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per muajin e fundit (duke marre si reference data e hapjes se ofertave).

Një punonjës mund të disponojë një ose më shumë se një certifikim.

Për të vërtetuar disponimin e stafit te mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm.
- Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente sipas legjislacionit në fuqi, per muajin e fundit (duke marre si reference data e hapjes se ofertave).

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. - Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç	Po [] Jo []
	Nëse, po, numri i punonjësve:

përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Profili i punonjësve
	<u>Makineri e mjete</u>
	Po [] Jo []
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

